



Republika e Kosovës / Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash / Skupština Opštine Dragaj



Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), neni 17, neni 40 dhe neni 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 qershor 2008), neni 37 i Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, neni 12 paragrafi 1 pika 1.6, neni 15, neni 29 dhe neni 31 paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 32 paragrafi 32.2 i Statutit Komunës së Dragashit 01 Nr. 06-103/1 të datës 11 shtator 2008. në seancën e Kuvendit të Komunës së Dragashit, të mbajtur më 14.10.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak të raportit për vlerësimin e dëmeve me nr. të protokollit 02Nr.325/04-27222/24 të dt. 08.10.2024 miraton këtë:

## VENDIM

### PËR

### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË EKONOMI FAMILJARE, BUJQËSI DHE BIZNESE

#### Neni 1

Miratohet Raporti i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në ekonomi Familjare, Bujqësi dhe Biznese, të cilat kanë ndodhur si pasojë e vërshimeve të cilat kanë ndodhur gjatë muajit qershor 2024.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera me nr. të protokollit 02Nr.325/04-27222/24 të dt. 08.10.2024.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për mbrojtje shpëtim dhe shërbime publike.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal, dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës, sipas kushteve të parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Agjencisë për Menaxhimin Emergjent,
- Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike,
- MAPL-së.
- Arkivit.

01.Nr. 060/01-27281-1/24

Dt. 14.10.2024

Kryesuesja e Kuvendit  
Arijeta Skeraj



*A. Skeraj*